



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.09.2018, ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 18.09.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 24 shtator – 12 tetor 2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”.
4. Diskutim lidhur me plotësimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Albana Shkurta - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Lindita Meneri - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Përparim Mezini - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, meqenëse plotësohet kuorumi për të vazhduar mbledhjen.

Sot në rend dite kemi: miratimin e procesverbalit të komisionit të datës 18.09.2018; miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 24 shtator – 12 tetor 2018; shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”; si dhe diskutime lidhur me plotësimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me miratimin e procesverbalit të komisionit të datës 18.09.2018.

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 24 shtator – 12 tetor 2018.

A ka vërejtje për kalendarin?

Vasilika Hysi – Kam unë diçka.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Me fillimin e paketës së ligjeve që lidhen me reformën në drejtësi, kam një sugjerim për sa i përket aktit të strategjisë “Për edukimin ligjor të publikut”, që është parashikuar të zhvillohet në datën 3 tetor. Nga Këshilli i Ministrave ne kemi kërkuar një vlerësim dhe një kontribut, por që ende nuk na ka ardhur asnjë përgjigje. Unë sugjeroj që ta shtyjmë në një datë tjetër këtë akt, ndërkohë që zyrtarisht t’i dërgojmë edhe një herë kërkesën Këshillit të Ministrave për ta kujtuar lidhur me këtë dokument. Unë mendoj se ky dokument do të jetë i fundit në paketë, pasi varet shumë nga ndryshimet që ne do të miratojmë edhe në ligjet që kemi në diskutim.

Ulsi Manja – A ka mendime të tjera lidhur me kalendarin? Nuk ka.

Atëherë, kjo çështje do të qëndrojë në kalendar, siç është parashikuar në datën 3 tetor. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk na e sjell përgjigjen brenda kësaj datë, atëherë ne do ta shtyjmë mbledhjen për një datë tjetër. Ne, së bashku me Këshillin e Ministrave, kemi rënë dakord që gjithçka që ka të bëjë me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi ata do të na

përgjigjen në kohë. Në qoftë se në datën 3 tetor nuk do të vijë përgjigjja, atëherë ne do ta shtyjmë mbledhjen për kalendarin tjetër.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Adnor Shameti.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zëvendësministren, zonjën Albana Shkurta, zonjën Lindita Meneri, përgjegjëse sektori, dhe zotin Përparim Mezini, përgjegjës sektori.

Zonja Shkurta, mirë se keni ardhur në komision!

Do t’ju lutesha për kolegët deputetë të na bënit shkurtimisht një prezantim të këtij projektligji.

Albana Shkurta - Qëllimi i këtij projektligji është për të mundësuar aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës dhe në aktin e Gjenevës. Të dyja këto akte bëjnë të mundur mbrojtjen e elementeve, që përbëjnë veçanti të produktit, siç janë origjina dhe treguesit gjeografikë.

Për t’ju dhënë disa shembuj konkretë, bëhet fjalë për elemente të tilla të një produkti që zotëruesit e markës mund të regjistrojnë duke shtrirë elementet e tyre të mbrojtjes, siç janë treguesit gjeografikë, vendi i origjinës, ose elemente, të cilat i japin produktit karakteristika të veçanta, pra karakteristika unike.

Ky projektakt është në listën e projektakteve të parashikuara për vitin 2018. Ky është një akt relativisht i ri, pasi është në proces ratifikimi edhe nga shumë vende të tjera të BE-së.

Çfarë mundëson aderimi i Shqipërisë në këto akte? Mundësia u jepet mbajtësve të markave të shprehen direkt në lidhje me regjistrimin e këtyre treguesve që njihen ndërkombëtarisht. Aktualisht, kjo mund të bëhet nëpërmjet regjistrimit të këtyre treguesve gjeografikë, pranë institucionit përgjegjës për pronësinë industriale në një vend. Ky vend në lidhje me marrëveshjet bilaterale, që ka me vendet e tjera, mundëson mbrojtjen e treguesit gjeografik për produkte të caktuara. Nëpërmjet aderimit në aktin e Gjenevës, kjo mbrojtje shtrihet ndërkombëtarisht në të gjitha ato vende që e kanë të ratifikuar këtë marrëveshje.

Për sa u përket kushteve në vendin tonë ose sa i rëndësishëm është ky akt për vendin tonë, mund të them se deri tani kemi 11 tregues gjeografikë të regjistruar, të cilët u përkasin zonave të ndryshme të Shqipërisë, siç janë produkte tipike, për shembull, gështenja e Tropojës, keci i Hasit. Pra, janë produkte, të cilat u japin mundësi atyre që i prodhojnë t’i tregtojnë duke

iu dhënë një karakteristikë unike, që nuk mund ta ketë i njëjti produkt i prodhuar në vende të tjera.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Shkurta!

Po ia kaloj fjalën relatorit, i cili, kërkoj ndjesë, është kolegu Alket Hyseni, për t'u shprehur shkurtimisht në lidhje me këtë projektligj.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji që vjen për shqyrtim sot, unë do t'i bie shkurt, është parashtesa që u bë nga përfaqësuesi i ministrisë, i cili ishte shterues në argumente, kështu që unë ftoj komisionin që ta votojë këtë projektligj, i cili qoftë në aspektin procedural, qoftë në aspektin ligjor është në përputhje me Rregulloren dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe, po ashtu, nga pikëpamja politike, është në përputhje me përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë dhe të qeverisë shqiptare, qoftë të programit të qeverisë në fushën e pronësisë industriale, qoftë të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Jashtë procedurës, do të kisha pasur dëshirë që drejtori Lako të kishte qenë i pranishëm sot për ta përfaqësuar, pasi ka qenë shumë aktiv në hartimin e këtyre projektligjeve dhe vazhdimisht kemi shkëmbyer mendime.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zonja Hysi, ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë kam dy pyetje.

E para, bazuar në relacionin që shoqëron marrëveshjen, vërej se ka vetëm 15 shtete që kanë firmosur dhe janë shtete të tilla, si: Burkina Faso, Kongo, Gaboni, Nikaragua, Mali, Peruja e Portugalia, ndërkohë që nuk shoh vende të Bashkimit Europian.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga lista që keni vënë këtu, nga vendet europiane janë vetëm Hungaria dhe Italia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe Portugalia.

Ndaj pyetja ime e parë është: si e shpjegoni që aktualisht e kanë firmosur këtë akt vende të tilla? Nuk ka interes, nuk ka ndonjë përfitim nga shteti apo ka kosto?

Në faqen e katërt të relacionit ju flisni për të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore, që sistemi i Lisbonës paska një deficit të ardhurash, i cili duhet eliminuar kryesisht nëpërmjet kontributeve të vendeve dhe Shqipëria nuk ka detyrim të likuidojë deficitin që ka, por këtej e

tutje duhet të paguajë. Pra, meqenëse nuk keni një faturë financiare, pyes: sa do t'i kushtojë Shqipërisë aderimi në këtë sistem dhe, së dyti, kostoja që përmendni ju këtu, duke marrë për krahasim Malin e Zi, është për regjistrimin e markës apo, siç thoni ju, të këtyre mallrave dhe të hapësirës gjeografike të tyre, apo është një *fee* vjetore? Nëse do të bëhet regjistrim, kush do ta paguajë? Do ta paguajë biznesi, qytetari, apo paguhet nga buxheti i shtetit?

Gjithashtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse ka kosto financiare dhe komisioni ynë këtë aspekt shikon.

E fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Ne shikojmë vetëm përputhshmërinë me Kushtetutën.

Vasilika Hysi – Kjo është pra, me Kushtetutën.

Alket Hyseni – Detyrimet për pagesën e tarifës, nëse më lejoni, profesoreshë, të bëj një sqarim, i ka pasur Republika e Shqipërisë edhe në ligjin aktual dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ja, ta mbaroj.

Alket Hyseni – ...i referohemi faktit se ne ndoshta nuk i kemi përmbushur, por jo se ky ligj ka ndonjë kosto.

Vasilika Hysi – Tani, unë kam një sugjerim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – E qartë, e qartë. Pyetja është e drejtë.

Vasilika Hysi – Ne kemi kaluar ligjin “Për pronësinë intelektuale” dhe atë “Për të drejtën e autorit”, të cilët janë ligje të rinj e të tjerë, se bëjmë ligje ku aderojmë, ndërkohë që nuk e di se sa i sensibilizojmë qytetarët, publikun dhe përfituesit për këto ligje për t'i njohur dhe për t'i shfrytëzuar. Ndaj, pyetja ime është: si e keni menduar zbatimin e këtij ligji? Këtë e kam në këndvështrimin e mbrojtjes së të drejtave më elementare që ka një prodhues, një biznesmen apo një përfaqësues i mbrojtjes së markave dhe patentave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja zëvendësministre.

Albana Shkurta – Në lidhje me pyetjen e parë, vetë si iniciativë kjo është relativisht e re. Bëhet fjalë për një marrëveshjeve ndërmjet vendeve në maj të vitit 2015.

Bashkimi Europian, si një i tërë, e ka pranuar në parim këtë marrëveshje, pra është vetëm çështje kohe derisa të gjitha vendet e Bashkimit Europian, një nga një, ta ratifikojnë.

Në listën që ne kemi siguruar, disa nga vendet e kanë ratifikuar tashmë, siç ishin: Hungaria, Italia dhe Portugalia, ndërkohë nga vendet e rajonit tonë e ka ratifikuar Mali i Zi, të cilin ne mund ta marrim si një shembull për të parë deri diku edhe krahasimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi i regjistrimit të treguesve gjeografikë vlen, në fakt, kryesisht për produktet që janë të natyrës bujqësore ose blegtorale. Vendet si Gjermania apo Franca, që nuk e kanë bujqësinë në thelbin e ekonomisë së tyre apo që nuk presupozohet që për bizneset e tyre të jetë një avantazh i madh konkurrues regjistrimi i treguesit gjeografik, si një element që t'i bëjë firmat e tyre më konkurruese, ndoshta për to nuk është aq prioritet se sa është për vendet, si: Shqipëria dhe Mali i Zi apo edhe vende të tjera, të cilat kanë potencial në këtë fushë për t'u dhënë zhvillim disa sektorëve të bujqësisë ose të blegtorisë, me qëllim që ato të jenë më konkurruese në rajon. Kjo është ideja.

Megjithatë, vendet e Bashkimit Europian, ato të gjitha, sipas një kalendari të caktuar, do ta ratifikojnë këtë marrëveshje.

Për sa i përket pyetjes tjetër, që është me shumë vend, se jo vetëm ky ligj por çdo ligj, në rast se nuk ekziston ndërgjegjësimi tek individët, të cilët preken direkt nga çdo ligj iniciative, ajo sigurisht, mund të mos zbatohet ashtu siç duhet. Megjithatë, DPPI-ja dhe si pjesë e strategjisë kombëtare, por edhe me ndihmën e shumë financimeve apo programeve të ndryshme, ka mundësuar ndërgjegjësimin në lidhje me këtë mundësi që u ofrohet prodhuesve për të pasur një mbrojtje shtesë apo një karakter unik për t'ia bashkëngjitur produktit me qëllim bërjen e tij më konkurrues, si shkak i kësaj iniciative janë edhe këta 11 treguesit e parë gjeografikë, që ne i kemi tashmë të regjistruar dhe, të gjithë ata që prodhojnë produkte nga këto zona, e dinë tashmë që kanë mundësi për ta shfrytëzuar këtë.

Për sa i përket buxhetit, është marrë si një treg i ngjashëm me ne ai i Malit të Zi, për sa i përket madhësisë apo intensitetit të përdorimit që mund të ketë në praktikë ky ligj. Bëhet fjalë për shuma pothuaj të pakonsiderueshme në krahasim me të ardhurat që përfiton Shqipëria si një vend në të cilin ka më shumë tregues gjeografik nga palë të treta sesa ne do të regjistrujmë.

Të paktën në këtë çast, nuk pritet të ketë ndonjë impakt negativ në buxhet.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Shkurta – Treguesit gjeografikë, ata të cilët aplikojnë për ta bërë këtë regjistrim, paguajnë një *fee* të caktuar, por në këtë moment nuk mund të gjykohet nëse kostoja totale e këtyre mund të mbulojë kostot që do të vijnë nga treguesit gjeografikë nga vendet e

tjera, që tashmë e kanë bërë këtë. Kështu, kjo është balanca për momentin. Ndërkohë, me kalimin e kohës ajo do të shkojë drejt zeros.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Shkurta!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime?

Alket Hyseni – Më lejoni, kryetar!

Ulsi Manja – Zoti Hyseni ka një diskutim.

Alket Hyseni – Në kuadër të kësaj, duke qenë se Drejtoria konkrete e Markave dhe e Patentave është një drejtori, që gjeneron shumë të ardhura, gjykoj se ministria edhe në kuadër të përmbushjes së këtyre detyrimeve ndërkombëtare, duhet të përmbushë detyrimet e saj kundrejt kësaj drejtorie. Ju vetëm ia merrni të ardhurat dhe nuk i lini mundësi për të gjeneruar qoftë projekte si drejtori, qoftë për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Prandaj, shfrytëzoj rastin me që është këtu përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, që t'i bëj thirrje ta ketë më në vëmendje këtë drejtori, e cila edhe në kuadër të anëtarësimit në BE, me shumë përparësi të luftojë në drejtim të mbrojtjes së pronësisë industriale dhe kjo nuk bëhet me fjalë, por bëhet me fonde.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit!

Kush është dakord në parim?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2. Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”.

Ky projektligj së bashku me raportin përkatës, do t’i përcillet seancës plenare për votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim lidhur me plotësimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës që është një diskutim lidhur me plotësimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Relatore të këtij projektvendimi janë koleget Vasilika Hysi dhe Klotilda Bushka.

Ju lutem, zonja Hysi, shumë shkurt!

Vasilika Hysi – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Sikurse jeni në dijeni Kuvendi i Shqipërisë ditën e enjte kishte në tryezë për votim një pjesë të kandidaturave për Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Ju e dini që morën votën nga seanca plenare 4 nga kandidatët e paraqitur seancës plenare. Është krijuar një vakancë dhe siç e komunikoi edhe Kryetari i Kuvendit, komisioni duhet të bëjë shpalljen e vakancës për këtë pozicion.

Meqenëse jemi me vonesë në lidhje me ngritjen e këtij komisioni dhe me qëllim që të mundësohet fillimi i funksionimit të tij, do t'ju kërkoja të nderuar kolegë që sot, të miratojmë një vendim dhe të bëjmë menjëherë shpalljen. Këtu do të kërkoja nga administrata e Kuvendit dhe meqenëse kemi edhe këshilltarët e komisionit, ta publikojë dhe të sensibilizojnë qytetarët, sepse shumë herë njoftimet që botohen në faqen e Kuvendit nuk aksesohen nga qytetarët. Qytetarët nuk mund të rrinë dhe të kontrollojnë se çfarë votojnë institucionet. Pra, të ketë një informim të medias dhe sensibilizim, me të gjitha instrumentet që ka Kuvendi i Shqipërisë, për të sensibilizuar dhe për të zgjedhur kandidatin ose anëtarin e pestë të këtij komisioni.

Gjithashtu, zoti kryetar, çështja që do të diskutojmë është se cili do të jetë minimumi i kandidatëve që do të pranohen për këtë pozicion. Pra, hapim përsëri një garë për një pozicion të paktën, duhet të dihet minimumi i kandidatëve që duhet të ketë.

Së treti, dua të theksoj se duhet të vëmë në dijeni Byronë e Kuvendit për të filluar procedurat për krijimin e administratës që do të mbështesë këtë komision, jo vetëm për mbështetjen logjistike, por edhe për buxhetin e nevojshëm që duhet të kenë dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Meqenëse kemi një vend vakant, them që në vendim të shprehemi "jo më pak se dy kandidatë".

Vasilika Hysi – Në rregull, edhe unë këtë mendim kam.

Ulsi Manja – Por është e rëndësishme që të zbardhet sot vendimi i Komisionit të Ligjeve dhe po sot të bëhet publikimi dhe shpallja.

Vasilika Hysi – Sa ditë do t’i lëmë?

Vasilika Hysi – Si vendimi, 15 ditë. Shumë mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kam përshtypjen se mund të bëhet nëpërmjet një shkrese që do t’i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, në emër të komisionit, lidhur me plotësimin e infrastrukturës së punës për këtë komision. Nuk besoj se kjo duhet të jetë pjesë e vendimit kjo.

Vasilika Hysi – Jo, nuk është pjesë e vendimit, është pjesë e administrative.

Ulsi Manja – Atëherë, këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës do të jetë nesër, ndërsa rendi i ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA

